



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 13/11/20 Ref.: 2749/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

#### V E N D I M

- I. Validohet programi i studimit të Kolegjit IBCM për periudhën 1 tetor 2020 – 30 shtator 2025:
  - Teknologji dhe Informatike e Aplikuar, Bachelor Profesional, 210 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik
- II. Validohet programi i studimit të Kolegjit IBCM për periudhën 1 tetor 2020 – 31 dhjetor 2024:
  - Administrate Publike dhe Mirëqenie, Bachelor Profesional, 210 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

I. Kolegji IBCM ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për validim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të

certifikatave dhe dëshmime të ofruara, rreth akreditimit dhe validimit të këtij institucioni nga Agjencia EVALAG, e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit IBCM
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



*G. Luboteni*

Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë